



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH. nr. 298/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “International Security Association” shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: “Sigurimi fizik i objektit komunal” me nr. të prok: 614-19-149-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Obiliqit, më datën: 04. 07. 2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “International Security Association” shpk, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: “Sigurimi fizik i objektit komunal” me nr. të prok: 614-19-149-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Obiliqit.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objektit komunal” me nr. të prok: 614-19-149-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Obiliqit.

**IV.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**V.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohen pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 28.01.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 20.02.2019

Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës 30.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim 30.05.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 10.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Me datën: 10.06.2019 tenderuesi “International Security Association” SH.P.K, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit komunal”, me nr. të prokurimit: ob614-19-149-2-2-1 dhe numri i brendshëm: 614 – 19 – 002 - 221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Obiliq.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni 59 — Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 4
- Neni 61 — Tenderi Jo-Normalisht të Ulët.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore i cili në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar:

### Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7)

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (**Barazia në Trajtim/ Jo-**



**Diskriminimi**) është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues i ka trajtuar në mënyrë të barabartë tenderuesin ankues, "International Security Association" SH.P.K nga Prishtina, sepse e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë ("ROSA-SECURITY" SH.P.K, nga Prizreni), në pajtueshmëri me Nenin 60 të LPP

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

#### **Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 59)**

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pa bazuar, sepse Tenderuesin Ankues, "International Security Association" SH.P.K nga Prishtina gjatë kalkulimit të pagës Bruto për një punëtorë, përsëri e ka përfshirë gabimisht edhe kontributin e punëtorit, i cili nuk është shpenzim për kompaninë.

Me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtueshmëri me Nenin 60 paragrafi 4:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paga e kalkuluar nga tenderuesi i shpallur fitues "ROSA-SECURITY" SH.P.K nga Prizreni është në pajtueshmëri me kërkesat e dhëna në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, sepse e ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Kalkulimi i pagës BRUTO nga "ROSA-SECURITY" SH.P.K nga Prizreni, është bërë në pajtueshmëri me kërkesën e dhënë në Dosjen e tenderit nga AK (*Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se Paga mujore neto për një(1) post (punëtor), nuk mund të jetë më e vogël se 270.00 €*), është kalkuluar në pajtueshmëri me kalkulimin që bëhet në pajtueshmëri me Ligjin për tatimin në të ardhurat Personale që është në faqen elektronike të ATK (Kalkulatori i PAGAVE nga NETO në BRUTO) <http://ëëë.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/>, shih ekstraktin e llogaritjes së pagës në vijim:

#### **Kalkulatori i pagave nga NETO në BRUTO**

**Llogaritja nga BRUTO NË NETO Llogaritja nga NETO NË BRUTO**

Paga mbi 450\*10%

Paga mbi 450

0.00

Gjithsej tatimi

9.13

PAGA BRUTO

293.82

1. Paga e punëtorit NETO 270.00 €
2. Kontributi nga punëtori 5 % = 14.69 € (*këtë shumë të kontributit e paguan punëtori*)
3. Kontributi nga punëdhënësi 5% = 14.69 €
4. Tatimi i pagës prej 80-250 = 6.80 €
5. Tatimi i pagës prej 250-450= 2.33 €
6. Gjithsej TATIMI i pagës= 9.13 €
7. Paga BRUTO, Paga NETO 270.00 € + Kontributi nga punëdhënësi 14.69 € + Tatimi në pagë 9,13 € = **293.82 €**
8. Dy punëtor të angazhuar në projekt me paga mujore nga 293.83 € x 2 = 587.64€
9. Pagat e punëtorëve 587.64 € + TVSH 18 % = 693.42 €
10. Pagat bruto me TVSH, për dy të punësuar është 693.42 € x 36 muaj =24,963.12 € euro

Meqenëse oferta e shpallur fituese në shumë prej 25.344,00 €, është ofertë financiare që i mbulon shpenzimet e punëtorëve të angazhuar për sigurimin e objektit të AK. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura, rezulton se pretendim i tenderuesit ankues se kompania e shpallur fituese nuk e ka kalkuluar pagën si duhet nuk qëndron.

Meqenëse për këtë tender ka pas ankesa në OSHP nga OE- Internat Security Association"SH.P.K., Mustafë Kruja nr.3, 10000, PRISHTINE OSHP me datë 12.04.2019 bie vendim që lënda të kthehet në RI-Vlerësim dhe gjatë rivlerësimit AK në bazë të rekomandimeve nga OSHP merr sqarim nga ATK se lidhur me kalkulimin e pagës.

Atëherë AK me datë 03.05.2019 nr. XIII-110 i drejtohet ATK me shkresë në mënyrë që ta bëjnë sqarimin dhe kalkulimin e pagës në mënyrën e duhur.



ATK i përgjigjet kërkesës së AK me datë 03-05-2019 dhe jep kalkulimin e duhur të pagës, shihni tab. si më poshtë nga ATK

Sa i përket rastit konkret të pagës bruto prej 293.82, në vijim e gjeni përlllogaritjen e pagës

Paga BRUTO	Kontributi nga punëtori (5%)	Kontributi nga punëdhënësi (5%)	Gjithsej Kontributi	Paga që tatohet	Gjithsej taksa	Paga NETO
293.83	14.69	14.69	29.39	279.13	9.13	270.00

Shënim: Të ardhura të tatueshme — Kur nga paga bruto zbriten kontributet pensionale, atëherë pjesës së mbetur i referohemi si “të ardhura të tatueshme”. Pra, nga shuma e pagës bruto, fillimisht zbritet Kontributi Pensional i të punësuarit dhe më pastaj shuma e mbetur tatohet.

Andaj AK mendon se OE ka ofruar çmimin mujor prej 704.00€, ndërsa çmimit total i OE është 25.344,00€ pra çmimi i ofruar nga OE është çmim që i mbulon shpenzimet e punëtorëve të angazhuar për sigurimin e objektit të AK.

Eksperti shqyrtues, konstaton se, Kalkulimi i pagës BRUTO edhe në bazë të sqarimit zyrtar nga ATK është bërë në mënyrën e duhur.

#### **Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 61)**

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, **(Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) është i pa bazuar**, sepse nuk kemi të bëjmë me çmim Jo normalisht të ulët, sepse të gjitha ofertat janë të përafërta me çmimet e ofruara.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e **Tenderuesit ankues të refuzohet e pabazuar** (për arsyen që u cek më lart), njëherësh propozoj që të aprovohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe të vazhdojë sipas dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik OE ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 20 qershor 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Me anë të këtij kalkulatori mund të llogarisni pagën BRUTO

Punëdhënësi\*

Primar

Paga NETO\*

270

Kontributet pensionale

Kontributi i punëtorit %\*

5 Shenoni përqindjen e kontributit në barrë të punëtorit në shifra (p.sh. për 5% shenoni 5).  
Kontributi pensional duhet të jetë prej 5% -15%, kurse për shtetasit e huaj nuk llogaritet.

Untitled

Gjithsej kontributi i punëtorit

14.69

Untitled

Kontributi i punëdhënësit %\*

5 Shenoni përqindjen e kontributit në barrë të punëdhënësit në shifra (p.sh. për 5% shenoni 5).  
Kontributi pensional duhet të jetë prej 5% -15%, kurse për shtetasit e huaj nuk llogaritet.

Untitled

Gjithsej kontributi i punëdhënësit

14.69

Untitled

Gjithsej kontributet

29.38

Paga që tatohet

279.13

Shkallët tatimore:

Paga prej 0-80 e

Paga prej 0-80

0.00

Llog tatuar per 80-250

Llog tatuar per 80-250 \* 4%

Paga prej 80-250

6.80

Llog tatuar per 250-450

Llog tatuar per 250-450/2nj > ZERO

Paga prej 250-450

2.33

Llog tatuar mbi 450



Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 20 qershor 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për anulim të aktivitetit, ankesat e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues profesional, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë të OE ankues deklaroi: “Ne lidhje me ankesën që kemi bërë ne kemi vërejtë që është bërë një gabim në kalkulim të OE fitues të cilin nëse me lejon do të jua shpjegoj në mënyrë të thjeshtë me një kalkulim që kam prezent tani në seancë: Paga Bruto për 1 punëtor është kërkuar të jetë 293.82 euro kur është kjo page kështu paga neto për një punëtor duhet të dalë 270 euro të cilën edhe mund të kalkulojmë në faqen zyrtare të ATK-se, pasi herën e kaluar kam filluar prej 270 euro neto mi shtuar kontributet dhe tatimin në burim mirëpo nuk kanë mundur që ne shkojmë në këtë mënyrë. Kalkulimi 293.82 Bruto page minus 14.69 kontribut nga Punëdhënësi 14.69 nga Punëmarrësi edhe tatimi në burimi pagës është 9.13 euro atëherë kur i zbresim të gjitha këto pagës bruto paga neto ka me dalë 255.31 euro. Edhe Autoriteti Kontraktues edhe E. SH. thonë se punëmarrësi duhet të paguaj vet kontributin, në rregull por punëmarrësi ku do të merr ato? Ne si OE jemi të obliguar të paguajmë të gjitha këto tatime, kështu që pagës 293.82 duhet të shtohet edhe një 5% kontribut nga punëmarrësi me qëllim që ne të arrijmë të paguajmë pagën neto 270 Euro”.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Hoti i cili deklaroi: “Ne i kemi dhënë të gjitha në shkresat që kemi dërguar meqenëse ky AP ka qenë në OSHP edhe herën e kaluar dhe është hera e 2-të kjo tani edhe pse E. SH. e ka vlerësuar sipas nesh herën e parë në rregull Paneli ka sjell vendim që lënda të kthehet në rivlerësim ku gjatë rivlerësimit ti behet një shkresë ATK-se që të na qartësojë kalkulimin e pagës, ne e kemi zbatuar vendimin, ATK na ka kthyer shkresën të cilën po ia dorëzoj panelit shqyrtues si provë Shkresën Zyrtare lidhur me kalkulimin e pagës ndërmjet Autoriteti Kontraktues dhe ATK-se”.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Vllasaliu e cila deklaroi: “Gjatë hartimit të ekspertizës pas shikimit të lëndës dhe kontrollit të dokumenteve të dorëzuar nga OE jam bindur se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin në pajtim me ligjin e prokurimit dhe me të drejtë e ka vendos



OE fitues. Deklaroj se pretendimet e OE ankues janë te pabazuara, dhe propozoj te aprovohet vendimi i Autoriteti Kontraktues për dhënie te kontratës”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: “Kërkojmë qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim”

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: “Propozojmë te refuzohet ankesa e OE si e pabazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues i ka trajtuar në mënyrë të barabartë tenderuesin ankues, “International Security Association” SH.P.K nga Prishtina, sepse e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë ("ROSA-SECURITY" SH.P.K, nga Prizreni), në pajtueshmëri me Nenin 60 të LPP.

Paneli shqyrtues konstaton se është i pabazuar se OE ankues “International Security Association” SH.P.K nga Prishtina gjatë kalkulimit të pagës bruto për një punëtor, përsëri e ka përfshirë gabimisht edhe kontributin e punëtorit, i cili nuk është shpenzim për kompaninë.

Paga e kalkuluar nga tenderuesi i shpallur fitues "ROSA-SECURITY" SH.P.K nga Prizreni është në pajtueshmëri me kërkesat e dhëna në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kalkulimi i pagës BRUTO nga "ROSA-SECURITY" SH.P.K nga Prizreni, është bërë në pajtueshmëri me kërkesën e dhënë në Dosjen e tenderit nga AK (*Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se Paga mujore neto për një(1) post (punëtor), nuk mund të jetë më e vogël se 270.00 €*), është kalkuluar në pajtueshmëri me kalkulimin që bëhet në pajtueshmëri me ligjin për tatimin në të ardhurat personale që është në faqen elektronike të ATK.

- Paga e punëtorit NETO 270.00 €
- 2 Kontributi nga punëtori 5 % = 14.69 € (*këtë shumë të kontributit e paguan punëtori*)



- Kontributi nga punëdhënësi 5% = 14.69 €
- Tatimi i pagës prej 80-250 = 6.80 €
- Tatimi i pagës prej 250-450 = 2.33 €
- Gjithsej TATIMI i pagës = 9.13 €
- Paga BRUTO, Paga NETO 270.00 € + Kontributi nga punëdhënësi 14.69 € + Tatimi në pagë 9,13 € = **293.82 €**
- Dy punëtor të angazhuar në projekt me paga mujore nga 293.83 € x 2 = 587.64€
- Pagat e punëtorëve 587.64 € + TVSH 18 % = 693.42 €
- Pagat bruto me TVSH, për dy të punësuar është 693.42 € x 36 muaj = 24,963.12 € euro

Meqenëse oferta e shpallur fituese në shumë prej 25.344,00 €, është ofertë financiare që i mbulon shpenzimet e punëtorëve të angazhuar për sigurimin e objektit të AK. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura, rezultojnë pretendimi i tenderuesit ankues se kompania e shpallur fituese nuk e ka kalkuluar pagën si duhet, nuk qëndron.

AK me datë 03. 05. 2019 në bazë të rekomandimeve nga OSHP në vendimin paraprak ka kërkuar sqarime nga lidhur me kalkulimin e pagës të cilët kanë sqaruar se:

Paga BRUTO	Kontributi nga punëtori (5%)	Kontributi nga punëdhënësi (5%)	Gjithsej Kontributi	Paga që tatohet	Gjithsej taksa	Paga NETO
293.83	14.69	14.69	29.39	279.13	9.13	270.00

Kur nga paga bruto zbriten kontributet pensionale, atëherë pjesës së mbetur i referohemi si “të ardhura të tatueshme”, pra, nga shuma e pagës bruto, fillimisht zbritet Kontributi Pensional i të punësuarit dhe më pastaj shuma e mbetur tatohet.

Andaj, AK mendon se OE ka ofruar çmimin mujor prej 704.00€, ndërsa çmimit total i OE është 25.344,00€ pra çmimi i ofruar nga OE është çmim që i mbulon shpenzimet e punëtorëve të angazhuar për sigurimin e objektit të AK.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim akimor është i pabazuar sepse nuk kemi të bëjmë me çmim jo normalisht të ulët, sepse të gjitha ofertat janë të përafërta me çmimet e ofruara.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – KK Obiliqit

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.